



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 11 , datë 11.7.2016

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC-ET “LASHKIZË 1”
DHE “LASHKIZË 2”, ME VENDNDODHJE: PELLGU UJËMBLEDHËS
I PËRRENJVE TË LASHKIZËS, VLLATHIT DHE SHEHUT, BASHKIA
DIBËR, QARKU DIBËR**

Në mbështetje të, shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, nenit 102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i procedurave administrative”, vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim burimi ujur”, për prodhim hidroenergjie, shoqërisë “HEC Lashkiza” sh.p.k., për HEC-et “Lashkizë 1” dhe “Lashkizë 2”, me vendndodhje: pellgu ujëmbledhës i përrenjve të Lashkizës, Vllathit dhe Shehut, Bashkia Dibër, Qarku Dibër.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të lejes së mjedisit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fushën e mjedisit.

ZËVENDËSKRYETAR

NIKO PELESHI

